



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministartstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

|                                           |                                                                                                                    |                                           |
|-------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------|
| Për:                                      | Izmir Zeqiri, Kryetar i Komunës së Zubin Potokut<br>Vedat Mehmeti, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Zubin Potokut |                                           |
| Kopje:                                    | Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL<br>Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë               |                                           |
| Përmes:                                   | Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së<br>Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së                               |                                           |
| Nga:                                      | Erbil Hetemi, Drejtor i Departamentit Ligjor, MAPL                                                                 | <b>Data:</b><br>02.05.2025<br>VI- 020-264 |
| Zyrtarët përgjegjës:                      | Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave<br>Ramadan Potera, Zyrtar për Monitorim të Komunave  |                                           |
| 1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor |                                                                                                                    |                                           |
| 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor    |                                                                                                                    |                                           |
| Lënda:                                    | Konfirmim i ligjshmërisë                                                                                           |                                           |
| Lloji i aktit:                            | Vendim i kuvendit të komunës së Zubin Potokut                                                                      |                                           |

I nderuar Kryetar,  
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 Për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 14/2023 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

|                                                                                                                                                                        |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Vendim Nr. Protokoli 020-264 për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë Ministrisë së Punëve të Brendshme, pa procedura konkurrimi.</b> |
| <b>I miratuar më datë: 30.04.2025</b>                                                                                                                                  |
| <b>I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 02.05.2025</b>                                                                                                          |

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi, ndërsa sa i përket përmbajtjes së aktit si dhe obligimeve ndaj palëve tjera janë në përgjegjësi të komunës.

### Arsyetim

**Vendimi Nr. Protokoli 020-264 për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë Ministrisë së Punëve të Brendshme, pa procedura konkurrimi.**

MAPL konstaton se akti i miratuar nga kuvendi i komunës së Zubin Potokut, është bazuar në nenin 12, 14 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 21 paragrafi 1.1, të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 24 paragrafi 6.4 të Rregullorës (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, vendimi është miratuar në mbledhjen e rregullt të kuvendit të komunës së Zubin Potokut e mbajtur me datë 30.04.2025, i miratuar me 11 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

|                                             |                                                                                                                |                                     |
|---------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------|
| Za :                                        | Izmi Zeqiri, gradonačelnik opštine Zubin Potok<br>Vedat Mehmeti, predsedavajući Skupštine opštine Zubin Potok  |                                     |
| Kopija:                                     | Jedinici za administraciju dokumenata u MALS<br>Jedinici za administraciju dokumenata u opštini                |                                     |
| Preko:                                      | për Elbert Krasniqi, ministar MALS-a, Jekuf Krasniqi<br>Jeton Qela, generalni sekretar MALS-a, Zerrin          |                                     |
| Od:                                         | Erbilin Hetemi, rukovodilac Pravnog odeljenja, MALS                                                            | Datuma,<br>02.05.2025<br>VI-020-264 |
| Odgovorni službenici:                       | Xhevat Tafa, rukovodilac odseka za monitorisanje opština<br>Ramadan Potera, službenik za monitorisanje opština |                                     |
| 1.Službenik za potvrđivanje pravne procene: |                                                                                                                |                                     |
| 2.Službenik za izradu pravne procene        |                                                                                                                |                                     |
| Predmet:                                    | Potvrda zakonitosti akta opštine Zubin Potok                                                                   |                                     |
| Vrsta odluke:                               | Odluka                                                                                                         |                                     |

Poštovani/a gradonačelnice,  
Poštovani/a predsedavajući,

U skladu sa članom 9 Zakona br. 08/L-284 o Administrativnom preispitivanju akata opština u skladu saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 10/2019 o administrativnom razmatranju opštinskih akata, kao i Uredbom br. 06/2021 o dopuni - izmeni Uredbe (VRK) br.10/2019, o administrativnom razmatranju opštinskih akata, a na osnovu zakonskih ovlašćenja ministarstva definisanih osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 14/2023, o administrativnim oblastima i nadležnostima Kancelarije premijera i ministarstava, Pravno odeljenje i monitorisanje opština MALS-a, primilo je na obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

|                                                                                                                                           |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Odluka br. Protokol 020-264 o davanju nepokretne imovine opštine na dugoročno korišćenje Ministarstvu unutrašnjih poslova, bez konkursa." |
| Usvojen dana 30.04.2025                                                                                                                   |
| Predložena na razmatranje u MALS-u dana, 02.05.2025 godine                                                                                |

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je opštinski akt u proceduralnom aspektu u saglasnosti sa odredbama zakonodavstva na snazi.

## Obrazloženje

Odluka br. Protokol 020-264 o davanju nepokretne imovine opštine na dugoročno korišćenje Ministarstvu unutrašnjih poslova, bez konkursa."

MAPL konstatuje da je akt koji je usvojen od strane skupštine opštine Zubin Potok zasnovan na članu 12, 14 i 58 Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi, članu 21 stav 1.1 Zakona br. 06/L-092 o davanju u korišćenje i razmeni nepokretne imovine opštine, članu 24 stav 6.4 Pravilnika (QRK) br. 09/2020 o određivanju procedura za davanje u korišćenje i razmenu nepokretne imovine opštine, odluka je usvojena na redovnoj sednici skupštine opštine Zubin Potok održanoj dana 28.03.2025. godine, usvojena sa 13 glasova za, 0 protiv i 0 uzdržanih.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za bilo kakva dalja pojašnjenja u vezi sa ovom procenom.